



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 23 prill 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për Leje për Apelim të Vendimit për
Pranimin e Materialeve P1064 dhe P1065**

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Luka Mishetiq

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të nenit 45(2) të Ligjit nr. 05/L 053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullës 77 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 19 mars 2024, Trupi Gjykues dëgjoi dëshminë e W04571-shit dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") e pyeti dëshmitarin për dy dokumente që përmbanin shënime nga një burim i panjohur. ZPS-ja i paraqiti dokumentet për pranim si prova, Mbrojtja kundërshtoi pranimin e tyre, dhe Trupi Gjykues udhëzoi Zyrën Administrative t'i shënonte për identifikim deri në vendimin e Trupit Gjykues mbi pranimin e tyre.¹

2. Më 25 mars 2024, mbasi Mbrojtja pati mundësinë të merrte në pyetje W04571-shin² dhe pasi dëgjoi parashtrimet e palëve lidhur me pranueshmërinë e dy dokumenteve,³ Trupi Gjykues lëshoi urdhër gojor për pranimin e dokumenteve si prova ("Vendimi i Kundërshtuar").⁴ Zyra Administrative u caktoi dokumenteve numra prove, përkatësisht P01064 dhe P01065.

3. Më 2 prill 2024, Mbrojtja e Kadri Veselit ("Mbrojtja e Veselit") dorëzoi kërkesë për leje për apelim të Vendimit të Kundërshtuar ("Kërkesa").⁵

¹ Transkripti i seancës, 19 mars 2024, f. 13412-13421, 13422-13424.

² *Shih* transkriptin e seancës, 20 mars 2024, f. 13434, rreshtat 13-17.

³ *Shih* transkriptin e seancës, 20 mars 2024, f. 13434, rreshti 18 – f. 13435, rreshti 22; Transkripti i seancës, 20 mars 2024, f. 13498-13516.

⁴ Transkripti i seancës, Urdhër Gojor për Pranimin e MFI P01064 dhe MFI P01065, 25 mars 2024, f. 13519-13522.

⁵ F02216, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes së Veselit për Leje për Apelim të Vendimit për Pranimin e Materialeve P1064 dhe P1065*, 2 prill 2024.

4. Më 15 prill, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") iu përgjigj Kërkesës duke e kundërshtuar atë ("Përgjigjja").⁶ Mbrojtja e Veselit nuk dorëzoi kundërpërgjigje.

II. PARASHTRIMET

5. Mbrojtja e Veselit kërkon leje për apelimin e Vendimit të Kundërshtuar bazuar në dy pikat e mëposhtme lidhur me vendimin e Trupit Gjykses për pranimin e materialeve P01064 dhe P01065:

1. Nëse Trupi Gjykses gaboi në Vendimin e Kundërshtuar duke përmbysur detyrimin e vërtetimit në mënyrë të palejueshme; dhe
2. Nëse Trupi Gjykses gaboi në Vendimin e Kundërshtuar kur bëri konstatime faktike që nuk bazohen në prova ose përfundime të arsyeshme.⁷

6. ZPS-ja përgjigjet se asnjëra nga pikat nuk është e apeluueshme. Pika e parë shtrembëron Vendimin e Kundërshtuar dhe është thjesht mospajtim me konstatimet e Trupit Gjykses.⁸ Pika e dytë nuk është konkrete dhe e identifikueshme dhe në mënyrë të palejueshme paraqet argumente të reja për pranimin e një prej dokumenteve.⁹ Së fundi, ZPS-ja parashtrohet se Mbrojtja e Veselit nuk demonstroi asnjë dëm konkret dhe as nuk trajtoi se si zgjidhja e cilësdo prej pikave do ndikonte në procesin gjyqësor.¹⁰

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

7. Sipas nenit 45(2) dhe rregullës 77(2), e drejta për apel lind vetëm nëse është përmbushur standardi për miratimin e lejes për apel i përcaktuar në këto dispozita. Rregulla 77(2) përcakton se:

⁶ F02244, Prokurorja e Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes së Veselit për Leje për Apelim të Vendimit për Pranimin e Materialeve P1064 dhe P1065*, konfidenciale, 15 prill 2024. Versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë (F02244/RED).

⁷ Kërkesa, para. 2.

⁸ Përgjigjja, para. 3-5.

⁹ Përgjigjja, para. 6-10.

¹⁰ Përgjigjja, para. 11-12.

Paneli miraton lejen në qoftë se vendimi lidhet me një çështje që do të ndikonte ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, ose në rezultatin e gjykimit, ndër të tjera, në qoftë se mjetet e përshtatshme juridike praktikisht nuk do të mund të miratoheshin pas mbylljes së çështjes që gjykohet dhe për të cilën, një vendim i menjëhershëm nga ana e panelit të Gjykatës së Apelit mund të kontribuojë thelbësisht në procesin gjyqësor.

Trupi Gjykses përfshin përmes referencave dispozitat ligjore përkatëse mbi standardin ligjor për miratimin e lejes për apel, të përcaktuar në vendimet e tij të mëparshme.¹¹

IV. DISKUTIM

8. Te pjesa relevante e Vendimit të Kundërshtuar, Trupi Gjykses trajtoi kriteret për pranimin e provave sipas rregullës 138, dhe së pari konstatoi se dokumentet P01064 dhe P01065 ishin pjesërisht relevante për provat dhe argumentet e ZPS-së sepse i referohen një numri viktimash të pretenduara të krimeve të paraqitura në aktakuzë.

9. Sa i përket autenticitetit *prima facie* të këtyre dokumenteve, Trupi Gjykses vuri re se të dy dokumentet, të sekuestruara nga autoritetet serbe, duket që u referohen anëtarëve, mbledhjeve dhe operacioneve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ("UÇK"), që mbështet sugjerimin se janë dokumente të UÇK-së. Trupi Gjykses gjithashtu mbajti parasysh faktin se dëshmitari W04571 dha dëshmi që përputhej me shënimet në dokumentet dhe se këto dokumente konfirmohen nga shënime të tjera me shkrim dore që janë pjesë e provave. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses shqyrtoi argumentet e Mbrojtjes se këto dokumente ishin ose mund të

¹¹ F01237, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim të Vendimit mbi Nxjerrjen e Informacionit për Dëshmitarët me Status të Dyfishtë*, 30 janar 2023, para. 7-8; KSC-BC-2020-07, F00484, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Leje për Apelimin e Vendimit F00470*, 8 dhjetor 2021, para. 4-14; F00423, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesat e ZPS-së për Leje për Apelim të Vendimit F00413 dhe Efekt Pezullues*, ("Vendimi mbi Lejen për Apelim në Çështjen Gjyqësore 07"), 8 nëntor 2021, para. 13-21; F00372, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Haradinajt për Leje për Apelim të F00328*, 15 tetor 2021, para. 15-17. Shih gjithashtu KSC-BC-2020-06, F00172, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apel*, 11 janar 2021, para. 6-7, 9-17.

jenë trillime ose dokumente të manipuluar. Trupi Gjykses nuk konstatoi ndonjë tregues tjetër lidhur me dokumentet në fjalë përveçse ato ishin shënime lidhur me informacion zbulimi dhe kundërzbulimi të mbledhur nga individë të panjohur për persona që dyshoheshin se bashkëpunonin me serbët. Gjithashtu, nuk kishte asnjë tregues para Trupit Gjykses se dokumentet ishin përpiluar apo manipuluar nga zyrtarë shtetërorë serb. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstatoi se dy dokumentet ishin *prima facie* autentike.

10. Sa i përket Kërkesës që po shqyrton aktualisht, Trupi Gjykses vëren që në fillim se Mbrojtja e Veselit i ka kushtuar disa faqe të Kërkesës argumentimit të themelësisë së apelit të mundshëm,¹² kamufluar nën titullin “Pikat Burojnë nga Vendimi i Kundërshtuar”.¹³ Mbrojtja e Veselit shkon aq larg sa paraqet argumente të reja për prejardhjen e materialit P01064.¹⁴ Në qoftë se kjo nënkupton kërkesë për rishikim, Trupi Gjykses vëren se këto argumente nuk përmbushin asnjë nga kriteret e rregullës 79.

11. Trupi Gjykses gjithashtu rithekson se vendimi për miratimin e lejes për apel sipas rregullës 77(2) nuk lidhet me faktin nëse vendimi i kundërshtuar është i saktë apo jo.¹⁵ Kur parashtuesi i kërkesës identifikon një pikë që buron nga vendimi në lidhje me të cilën kërkon leje për apel, pika e identifikuar duhet të jetë e qartë dhe

¹² Kërkesa, para. 7-22.

¹³ Kërkesa, f. 2; *shih gjithashtu* Kërkesën, para. 23 (ku pretendohen “gabime të dukshme”), para. 24 (ku pretendohen “gabime në arsyetim”).

¹⁴ *Shih* Kërkesën, para. 21; Përgjigjen, para. 8, që i referohet ICTR, *Prosecutor v. Bagosora et al.*, ICTR-98-41-T, [Decision on Request for Certification Concerning Sufficiency of Defence Witness Summaries](#), 21 July 2005, para. 5.

¹⁵ Vendimi mbi Lejen për Apelim në Çështjen Gjyqësore 07, para. 21; KSC-BC-2020-06, F00172, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apel*, 11 janar 2021, para. 17; STL, *Prosecutor v. Ayyash et al.*, STL-11-01/T/TC, [Decision Denying Certification to Appeal Decision under Rule 167 not to Acquit Hussein Hassan Oneissi and to Stay the Trial – with a Short Separate Opinion of Judge David Re](#), 14 May 2018, para. 8; ICTY, *Prosecutor v. Karadžić*, IT-95-5/18-T, [Decision on Accused's Application for Certification to Appeal Denial of Motion for Judgement of Acquittal Under Rule 98 Bis](#), 18 July 2012, para. 6; ICTR, *Prosecutor v. Nzabonimana*, ICTR-98-44D-T, [Decision on Defence Motion for Leave to Appeal the Trial Chamber' Decision on the Defence Request to Call Prosecution Investigators](#), 10 May 2011, para. 12.

konkrete, jo abstrakte ose hipotetike.¹⁶ Gjithashtu, pika duhet të burojë nga vendimi për të cilin kërkohet leje për apel, jo nga argumente ose elemente të reja që as janë ngritur as janë trajtuar në vendimin e kundërshtuar. Trupit Gjykues nuk ka për detyrë të vendosë për themelësinë e një apeli të mundshëm në një vendim sipas nenit 45(2) dhe rregullës 77(2). Argumentet lidhur me themelësinë e Vendimit të Kundërshtuar shkojnë përtej kuadrit të asaj që duhet të vendosë Trupi Gjykues këtu. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues nuk do t'i marrë parasysh si relevante parashtrimet që synojnë të trajtojnë themelësinë e Vendimit të Kundërshtuar.

12. Sa u përket kriterëve të rregullës 77(2), Trupi Gjykues kujton se pala që kërkon lejen për apelimin e një pike ka përgjegjësinë të vërtetojë se janë përmbushur kriteret për miratimin e lejes për apelim.¹⁷ Nuk i takon Trupit Gjykues të zëvendësojë palën që kërkon lejen për apelim, dhe kërkesat sipas rregullës 77(2) që nuk artikulojnë qartë kriteret e kësaj dispozite do të hidhen poshtë menjëherë. Sa i përket kriterit të parë të rregullës 77 (2), parashtruesi i kërkesës duhet jo vetëm të tregojë se si ndikon pika në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit ose në rezultatin e gjykimit, por duhet të demonstrojë gjithashtu se cilido nga këta faktorë do të ndikohej ndjeshëm.¹⁸

13. Këtu, Trupi Gjykues vëren se Mbrojtja e Veselit thjesht pretendon, pa dhënë shpjegim, se është “thelbësore që këto gabime të trajtohen, në mënyrë që të mbrohet e drejta e z. Veseli për gjykim të drejtë”.¹⁹ Mbrojtja e Veselit më pas thekson se duhet t'i miratohet leje për apelim, për të garantuar se: (i) “detyrimi i vërtetimit respektohet” dhe se (ii) “Trupi Gjykues ka për detyrë të marrë vendime bazuar në prova dhe përfundime të arsyeshme”.²⁰ Mbrojtja e Veselit nuk shpjegon

¹⁶ Vendimi mbi Lejen për Apelim në Çështjen Gjyqësore 07, para. 16; ICC, *Prosecutor v. Jean-Pierre Bemba Gombo*, ICC-01/05-01/08-75, [Decision on the Prosecutor's Application for Leave to Appeal Pre-Trial Chamber III's Decision on Disclosure](#), 25 August 2008, para. 11.

¹⁶ Kërkesa, para 7-22.

¹⁷ Vendimi mbi Lejen për Apelim në Çështjen Gjyqësore 07, para. 13.

¹⁸ Vendimi mbi Lejen për Apelim në Çështjen Gjyqësore 07, para. 17.

¹⁹ Kërkesa, para. 23.

²⁰ Kërkesa, para.23.

se si vendimi për pranimin e materialeve P01064 dhe P01065 mund të ndikojë ndjeshëm në kryerjen e drejtë të procesit, ose në rezultatin e gjykimit. Gjithashtu, Trupi Gjykses thekson se Paneli i Gjykatës së Apelit gjithsesi ka mundësinë të miratojë mjetin e duhur juridik nëse konstaton se Trupi Gjykses është mbështetur në mënyrë të palejueshme në materialet P01064 dhe P01065 në aktgjykimin përfundimtar.²¹

14. Në lidhje me kriterin e dytë, Mbrojtja e Veselit argumenton vetëm se “një vendim pozitiv nga Dhoma e Apelit në këtë fazë do të shmangte rrezikun e çdo efekti dëmtues ndaj të akuzuarit, duke e avancuar thelbësisht procesin gjyqësor”.²² Mbrojtja e Veselit në vijim thekson se një vendim i apelit do të sqaronte (i) “detyrimin e vërtetimit”, dhe (ii) “që Trupi Gjykses duhet të bazojë vendimet e veta mbi prova që janë pjesë e dokumentacionit të çështjes dhe nuk mund të spekulojë”.²³ Përsëri, Trupi Gjykses konstaton se argumentet e Mbrojtjes së Veselit nuk përmbushin standardin e nevojshëm sipas rregullës 77 (2). Mbrojtja e Veselit nuk shpjegon me konkretësi “rrezikun e [...] efekti[t] dëmtues” të pretenduar, dhe as arsyen pse një vendim i menjëhershëm i Panelit të Gjykatës së Apelit mbi pikat e paraqitura do ta avanconte thelbësisht procesit. Këto pretendime të përgjithshme dhe jokonkrete nuk përmbushin standardin e përcaktuar në Rregullore.

15. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja e Veselit nuk ka përmbushur kriteret për miratimin e lejes për apel, të përcaktuara në nenin 45 (2) dhe rregullën 77 (2).

²¹ *Shih* rregullën 77(2): “Paneli miraton lejen në qoftë se vendimi lidhet me një çështje që do të ndikonte ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, ose në rezultatin e gjykimit ndër të tjera, në qoftë se mjetet e përshtatshme juridike praktikisht nuk do të mund të miratoheshin pas mbylljes së çështjes që gjykohet [...]” (theksimi i shtuar).

²² Kërkesa, para. 24.

²³ Kërkesa, para. 24.

V. KLASIFIKIMI

16. Trupi Gjykses vë në dukje se Kërkesa u dorëzua vetëm në versionin konfidencial dhe Mbrojtja e Veselit shpjegon se aty u referohet të dhënave konfidenciale. Bazuar në rregullën 82 (5), Trupi Gjykses urdhëron Mbrojtjen e Veselit që deri të martën, 30 prill 2024, të dorëzojë versionin e redaktuar publik të Kërkesës, ose të kërkojë riklasifikimin e saj si publike. Trupi Gjykses i rikujton Mbrojtjes së Veselit urdhrin gojor në lidhje me parimin e procesit publik, me të cilin Trupi Gjykses urdhëroi palët dhe pjesëmarrësit, që si parim: (i) të dorëzojnë njëkohësisht edhe versionin e redaktuar publik të parashtrimit konfidencial; dhe (ii) kur ka arsye bindëse për të mos e bërë këtë, në pjesën e parashtrimit për klasifikimin të bëjnë të ditura arsyet pse versioni i redaktuar publik nuk mund të dorëzohet njëkohësisht.²⁴

VI. VENDIM

17. 30. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a) **HEDH POSHTË** Kërkesën; dhe
- b) **URDHËRON** Mbrojtjen e Veselit që deri të martën, 30 prill 2024, të dorëzojë versionin e redaktuar publik të Kërkesës, ose të kërkojë riklasifikimin e saj.

²⁴ Transkripti i seancës, 7 nëntor 2023, f. 9446, rreshtat 13-20. *Shih gjithashtu* F02241, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për Leje për Apelim të Vendimit për Pranimin e Materialit P1046*, 15 prill 2024, para. 29; F02157, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për Leje për Apelim të Vendimit për Pranimin e Materialeve P959 dhe P960*, 29 shkurt 2024, para. 18; F02067, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit F01963*, 19 janar 2024, para. 37.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E martë, 23 prill 2024

Në Hagë, Holandë.